



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Numri i lëndës: 2021:279653  
KA.nr.730/22  
Datë: 09.09.2024  
Numri i dokumentit: 06162984

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit IPSH “Jeta” SH.P.K, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga juristi A.P. sipas autorizimit të datës 04.09.2024, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit nr.10/K-063/21, të datës 10.11.2021, jashtë seancës me datë 09.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësit IPSH “Jeta” SH.P.K, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor, për shkak të anulimit të vendimit nr.10/K-063/21, i datës 10.11.2021.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi IPSH “Jeta” SH.P.K, me seli në Prishtinë, në kohën e parashtrimit të padisë e përfaqësuar nga pronari A.J., me datë 10.12.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e

Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të vendimit nr.10/K-063/21, të datës 10.11.2021.

Gjykata me datë 05.09.2024 mbajti seancë të shqyrtimit kryesor, në prezencë të përfaqësuesit të paditësit dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, konform nenit 41 të LKA-së, ftesën për seancë e ka pranuar me datë 09.08.2024, ftesës nuk i është përgjigjur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, juristi A.P., sipas autorizimit të datës 04.09.2024, në seancë të datës 05.09.2024 deklaroi se paditësi e tërheq padinë, pasi që nuk ka interes juridik për vazhdimin e kësaj çështje me arsyetimin se i njëjti gjobën e ka paguar, jeton jashtë shtetit dhe nuk është i interesuar që të vazhdojë me shqyrtim gjyqësor.

Gjykata konstaton se përfaqësuesi i paditësit me autorizim të datës 04.09.2024 është autorizuar që ti ndërmerr të gjitha veprimet procedurale në emër të paditësit përfshirë edhe heqjen dorë nga padia. Prandaj, konform nenit 261 paragrafi 3 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.730/22, me datë 09.09.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.